

# 15 SHEKUJ KRISTIANIZËM NË MES DY KRYEQYTETEVE TË ILIRISË

(SHKODËR-MEDUN)

Ndue **BACAJ**

Publicist, Studiues, Akademia “Rrënjët Tona”

## PËRMBLEDHJE

Kumtesa me titull “Shekuj Kristianizëm në mes dy kryeqyteteve të Ilirisë (Shkodër-Medun)”, përpiqet të tregojnë një histori të shkurtër rreth 15 shekullore të Kristianizmit “Institucional” në trojet Iliro-Shqiptare, në mes dy kryeqyteteve të Ilirisë, Shkodrës dhe Medunit si kryeqytet rezervë i Ilirisë. Për ta paraqitur këtë sa më vertetësisht jam përpjekur t’u referohem në mënyrë rigorozë shkrimeve, dokumenteve dhe botimeve të ndryshme të autorëve të huaj e vendas, gjithashtu edhe njohuritë e mia të bazuara nga trashigimia gojore dhe toponimet të cilat trashigohen edhe sot. Kumtesa ime ndahet: Hyrje, Histori e Shkurtër e Kristianizmit në Iliri. Kisha të shek.-V të zbuluara në trojet Iliro-Shqiptare të Malësisë së Madhe - Kisha Hot dhe Kisha Lohe e Sipërme. Trashigimi (të shkruara e gojore) dhe Toponime Kishash në Malësi. Lashtësia e Krishtëritimit ndër Iliro-Shqiptar dëshmohet, edhe me antroponimet e shumta Kristiane dhe pak informacion për disa Kisha pas shek.-X-të, Balleza e Rrënjët, Manastiri Benediktin i Shën Gjorit.

*Fjalë kyçe: Kristianizëm , Shkodër, Medun, Diokle, Malësi e Madhe, Kisha shek.V-Hot, Lohe e Sipërme, Kisha pas shek.X- Balleza, Manastiri i Shen Gjorit, Kisha të “vona” në Malësi të Madhe.*

## ABSTRACT

The paper tries to tell a short history of about 15 centuries of "Institutional" Christianity, in the Illyrian-Albanian lands between the two capitals of Illyria, Shkodra and Medun as the reserve capital of Illyria. To present this, I have tried to refer as strictly as possible to the writings, documents and various publications of foreign and local authors, as well as my knowledge based on oral heritage and toponyms which are still inherited today.

*Key word: Christianity, Shkodër, Medun, Diokle, Malësi e Madhe, Church V-Hot, Lohe e Sipërme, Church after X-Balleza, Monastery of Saint John, "late" churches in Malësi e Madhe.*

## HYRJE

Kumtesa ime e vogël perballë veprës së madhe të kishës Kristiane në trojet etnike Iliro-Arbënore-Shqiptare në Malësi të Madhe e më gjërë i ngjanë një rreze të vogël drite që përpiqet të ndriçoj e memorizoj sadopak hershmërinë e përhapjes së kristianizmit në trojet tona. Sot kemi më nevojë se kurr të “zbulojmë” rrënjët tona të besimit, qytetritimit dhe identitetit tonë Europërendimorë , rrënjë që u ngulitën në trojet tona që në shekujt e parë të përhapjes së Kristianizmit, dhe u konsoliduan nga shekulli i IV, kur me Ediktin e Milanos (viti 313) perandori i Romës, Kostandinit të Madh (Iliir nga Nishi i Dardanisë), do të ndalonte persekutimin e përndjekjen e atyre që përhapnin e përqaftonin besimin Kristian. Kristianizmi ka qënë kurdoherë i “shoqëruar” edhe me qytetrimin perëndimor dhe me ndërtimet e objekteve më të hershme kristiane të kohës, si Kisha, famulli, manastire etj. Ndërtimi i këtyre objekteve të besimit e qytetritimit kristian dëshmohet edhe në trojet e Malësisë së Madhe (Shqipëri) dhe në zonat kufitare të fqinjës sonë të vonë, Malit të Zi (Ish troje etnike shqiptare), apo më sakt në mes dy kryeqyteteve të Ilirisë, Shkodër-Medun.

## HISTORI E SHKURTË E KRISTIANIZMIT NË ILIRI

Të parët tanë Ilirët, duke qënë nën sundimin e Romakëve nuk e kishin të lehtë të përqafonin këtë fe e besim që predikonte për atë si Shëlbohet njeriu, por edhe për atë si jetohet dinjitetshëm në këtë Botë. Kristianizmi kërkonte që shoqëria njerzore në organizimet e saj të bazohet në parimet morale të paraqitura në ligjin e Moisiut, në Dhjetë Urdhërimet e Tënzot. Kristianizmin në Iliri nuk e përhapën as misionarë Latin e as ata Grek, atë në trevat tona e përhapri njëri ndër Apostujt e Jezu Krishtit, Shën Pali, i cili në letrën e tij derguar romakëve thotë: “Kështu qysh prej Jeruzalemit e përqark në Ilirik e kam përhapur Ungjillin e Krishtit”.

Dy martirët e parë Ilirë të Kristianizmit dëshmohen të jenë Flori dhe Lauri nga Dardania Ilire apo Kosova e sotme, për të cilët thuhet se nga profesioni i tyre ishin gurgdhendës (ndërtues), por edhe vëllezër binjakë të cilët jo vetëm nuk mohuan besimin tek Krishti, por në vend që të ndërtonin një tempull për të rremë paganë, siç e donte perandoria Romake ata ndërtuan një faltore kristiane. Flori e Lauri u mbytën nga të pafetë në afërsi të Prishtinës së sotme (në Ulpian). Si kohë e ekzekutimit shënohen vitet 98 -117 (mbas Krishtit), ndërsa si datë e këtyre dy martirëve Shenjtorë njihet data e 18 gushtit e shënuar në kalendarin katolik. Kisha katolike shqiptare që mban emrin e këtyre dy shenjtorëve ilir është në Grazhdanik të Kosovës.<sup>1</sup> Gjithashtu nga Iliro-Shqiptarët cilësohen rreth 600 martirë e shenjtorë të besimit Kristian, ku dhjetra nga këta kanë ditët e tyre të shënuara në kalendarët fetar të pëvithshëm edhe sot, si dhe katër Papë që kanë drejtuar ndër vite Selinë e shenjte nga shek.II deri në gjysmen e parë të shek.XVIII etj. Një dëshmi tjetër vjen edhe nga historiani i Kishës, Daniele Farlati, i cili pohon se bashkësia e Durrësit ishte më e vjetra në Shqipëri, e formuar nga Apostulli Pal, gjatë predikimeve të tij. Gjithashtu ai vuri në dukje se në vitin 58 në Durrës kishte 70 familje të krishtera, të cilat kishin si peshkop njëfarë Cezari apo Apolloni. E ndërsa perhapej me shpejtësi besimi Kristian, persekutimi e përndjekja e atyre që e përhapnin e përqafonin këtë besim vijonte. Përndjekjet e përgjakshme nga perandoria romake janë të shumta, ku nga këto po kujtojmë ato nga koha e Decit (249-251) që zgjaten deri në kohën e Dioklecianit (284-305). Kristianizmi si besim u lejua zyrtarisht vetëm nga Perandori Ilir, nga Nishi i Dardanisë, Konstandini i Madh, në vitin 313, me Ediktin e Milanos, ku ky edikt ndër të tjera theksonte: *Tash e tutje kush dëshiron të besoj në atë fe mund ta bëjnë atë lirisht, hapur dhe pa pengesa dhënien e të gjitha lirive të krishterëve për kryerjen lirisht të riteve të tyre.*

Konstandini jo vetëm e zbatoi me përpikmëri Ediktin e tij, por ndërmorri edhe një seri masash të efekshme që e nxori krishtërimin nga katakombet në dritë të diellit dhe kishat e katakombeve i zëvendësoi me katedralet madhështore, ndër ndertesat më të bukura që njerëzimi kishte parë deri atëherë. Pas kësaj në fakt pati një përhapje më të gjerë kjo fe e ky besim, e pikërisht disa studiuesë vendas e të huaj shkruajnë se shqiptarët (ilirët) u bënë në të shumtën të ‘Krishterë’ në shekujt e IV-V-të. Në këto kohë filloi edhe ndërtimi i tempujve e kishave, ku këtë e verteton zbulimi i rrënojave dhe trashigimisë kristiane që janë gjetur në tërë territoret Iliro-Shqiptare, kuptohet edhe në Malësinë e Madhe (në dy anët e kufirit politik) e më gjërë. Përhapja e Krishterimit në Iliri i përket historisë së shekujve të parë të këtij besimi. Gjurmët e paganizmit ilir zbehen shumë herët dhe zëvendësohen nga të dyja kishat me motive të krishtera. Edhe pas vitit 395, kur perandoria e Romës u nda në dy pjesë, Kisha kristiane shqiptare mbeti në mvarësi të Kishës së Romës (*Madje në trojet e veriut të Shqipërisë, kjo dëshmohet edhe pas vitit 1054, kur u nda zyrtarisht Kisha Katolike me atë Ortodokse*). Koncilet e këtyre kohëve dhe organizimi kishtar i më vonshëm, si dhe fillimi i ndarjes së kishës është kapitull në vete, por nuk ndryshoi thujtë asgjë nga besimi. Kur Iliria (Shqipëria), u nda në provinca, ajo veriore u quajt edhe Prevali që shtrihej nga lugina e Zetës dhe Maricës në Veri, së bashku me Dardaninë e deri në lumin Shkumbin në Jug, Doklea muar organizimin e qytetit si

---

<sup>1</sup> Vlenë të shënohet se për kishën kristiane-ortodokse dita e shenjtorëve Flori e Lauri shënohet me 31 gusht.

“municipium”(bashki) romake prej perandorit Vespasian ose të bijëve. Dioklea është ai qytet, ku mund të përvijohen deri në njëfarë mase linjat e urbanizimit antik dhe topografia e re kristiane, që krijohet në brendësi të rrethimit të saj. Me krijimin e provincës së Prevalit, dhe me mjaft gjasa, aty nga fundi i shek. IV, Shkodra del për herë të parë në dokumentacionin burimor si një Peshkopatë. Më vonë bëhet e qartë, se ajo ka qënë seli kryesore peshkopale dhe kryeqëndër e provincës. Megjithatë Shkodra kishte qënë kryeqendra e Ilirisë nga disa kujtime kishtare, emri i parë i Peshkopit Baso, mësohet vetëm rreth vitit 387. Megjithatë këto si seli ipeshkvnore primare (deri në vitin 602) në Shqipëri, duhet të konsiderohen edhe Dioklea, Sarda, Shkodra. Historiani (Jirecek), si dhe disa studiuesë të tjerë shkruajnë se qyteti i Dioklesë u rrënuar në kohrat e stuhishme të shekullit VII, por emri nuk u harrua kurrë. Ai thotë se këtu duket ka banuar një popullsi e vogël, ndonjëherë ka qënë qytet i famshëm dhe seli e peshkopit të Diokleas. Është interesant se ndonjëherë për Dioklen si qytet thuhet u shkatërrua në shekullin e VII, si qëndër e rëndësishme qytetare e fetare, kjo vijon të njihet për disa shekuj më vonë. Kjo mësohet pasi Këshilli i Dalmacisë që u mbledh në shekullin e IX shpalli Dioklenë Kishë mitropolitane, dhe i dha si sufragane (të varur) Shkodrën. Po nga ky burim mësojmë se në vitin 877 Tivari tashma një seli peshkopesh ishte nën varësinë e mitropolitës së Dioklesë. Madje studiuesi Hekardi, shkruan: “Peshkopata e më vonë kryepeshkopata e Dioklesë, titullari i të cilës ishte metropolit i Shqipërisë deri në vitin 927, kur ky qytet u shkatërrua nga Simeoni i Bullgarisë. Kryepeshkopi i fundit i Dioklesë quhej Gjoni, i cili (pas shkatërrimit të selisë) u strehua në Raguze, ku u bë peshkop i këtij qyteti, duke ruajtur megjithatë titullin e kryepeshkopit, selia e mitropolitës u transferua në Spalato (Split).

Ndërsa, Abanologu dhe historiani i njohur Milan Shuflaj shkruan: “Qytetet romane Dioklea, Sarda, Skampa, Apollonia, Amantia, Bylis, me kalimin e kohës u shkatërruan pjesërisht nga sulmet armike dhe pjesërisht nga “kënetëzimi” i ngadalshëm, porse ipeshkviat e tyre nuk u zhdukën, por pësojnë vetëm një metamorfozë. Ndoshta, ipeshkvi i Dioklesë e kishte rezidencën e tij për një kohë të gjatë tek rrënojat e këtij qyteti, porse tashma është jashtë çdo dyshimi, fakti që në shek. XI trashigiminë e tij e mori ipeshkvi i Tivari”. Vlenë të cilësohet se nga Dioklea kemi edhe një dëshmi tjetër mjaft interesante paleokristiane, të ashtuquajturën “kupa e Podgoricës”. Kjo kupë qelqi e zbuluar rreth vitit 1870, është botuar për herë të parë nga Dumont në vitin 1873. Që atëherë ajo është marrë në dorë nga studiues të ndryshëm. Megjithatë, ajo mbetet edhe sot një gjetje mjaft interesante e periudhës së hershme kristiane. Dëshmi të ndryshme të objekteve kristiane janë gjetur në varrezat e Kalldrunit (zbulim i viteve 1962-1963), ku përveç të tjerave janë gjetur edhe dy kupa qelqi të gjelbërta, si dhe në varret e gërmuara është gjetur kryesisht një lëndë arkeologjike të shek. - III-IV, të erës sonë me motive kristiane. Në Koplik (dhe sigurisht në rrethinën e gjërë të tij) janë parë rrënoja ndërtimesh dhe se aty u gjetën, midis të tjerave një figurë e vogël bronzi e Hyut Lar, një togëz e rumbullakët bronzi e perandorit romak Gordian III (vitet 238-242) etj.

## **PËRSEKUTIMI I KISHËS NDËR SHEKUJ**

Shqipëria, Greqia dhe Dalmacia bëjnë pjesë tek vendet e vjetra të krishtera, të cilat u shkatërruan nga dyndjet e sllavëve barbarë më pak se vendet e tjera, dhe në shek. IV-VI kishin një topografi me emra shenjësorësh shumë të pëhapur. Në mesjetën e vonë hasim në mbetje të një kulture shumë të vjetër kishtare. Në emra korridore të dokumentuara takojmë edhe emra shenjësorësh dhe gjurmë të fshira kishash të vogla, të ndërtuara dikur mbi vende tempujsh paganë. Gjithsesi gjatë shekujve “Fortuna e stuhia e detit, krisma e furia e ferrit janë përpjekur bashkë për t’i perpirë kishat tona”. E mjerisht jo pak edhe kanë arritur, ndaj jemi “kështu”. Edhe kleri kristian u trajtua shumë ashpër e dhunshëm, veçanërisht gjatë pushtimit turko-osman. Meshtarët merrëshin peng, e prej tyre nxirreshin shperblime të majme, veçanërisht kur në “rrjetë” binte ndonjë ipeshkëv. Nëse ky shterngim i lakut nuk do të jepte frutet e prituna, atëherë mund të vijohej me zbulimin e çatave të kishave, për me pengue zhvillimin e rriteve fetare, veçanërisht në dimër, ose do të

kërkohej respektimi i rregullave turke, të cilat nuk lejonin kisha ose ndërtesa kulturi deri në largësi sa iu rrokte syni autoriteteve turke. Janë pikrisht këto fortuna e stuhi që ndër shekuj na kanë shkatërruar jo pak nga rrënjët edhe nga dokumentacioni i hershmerisë kishtarë, duke na detyruar shpesh të marrim referenca disi të vonëshme.

## **KISHA TË SHEK.-V TË ZBULUARA NË TROJET ILIRO-SHQIPTARE TË MASLËSISË SË MADHE**

Nga mesi i dytë i shek. II deri në përndjekjet nga Diokleciani (303), kisha gëzon një fare paqeje, falë politikës së tolerances së ndjekur nga perandorët pasardhës të Valerit. Në perëndim themelohen njëqindë kisha, të shpërndara në një territor që shtrihet nga Iliria deri në Spanjë. Në tryshinë e lëvizjes së popujve dhe të forcave të natyrës në shek. VI dhe VII u zhduken shumë seli të dioqezave dhe nën sundimin e Justinianit u krijuan qytete të reja të fortifikuara, të cilat në atë kohë ose jo shumë më vonë patën edhe ipeshkvinjtë e tyre. Paganë e sllavë futën me forcë në krahinën e dikurshme të diokleatëve ilir. Megjithë këtë në trojet e Malësisë së Madhe janë zbuluar deri tani rrënoja të Kishave të Lashta si vijon:

***Kisha në lohe të sipërme:*** Në Lohe, si në trevat e tjera Ilire të Malësisë së Madhe, besimi Kristian është përhapur e perqafuar që në shekujt e parë. Këtë e tregon më së miri edhe zbulimi i një Bazilike trenefeshë në fshatin Lohe e Sipërme. Sipas autorit të gërmimit (Zamir Tafilica), kjo bazilikë është ndërtuar mbi një varreze të shekullit III. Në hapsirën e gërmuar pranë kësaj bazilike u gjetë edhe lëndë arkeologjike. Pjesën më të madhe të kësaj lënde e përbën qeramika, veçanarisht ajo e ndertimit, si copa tullash e tjegullash. Mjaftë të pranishme janë edhe fragmentet e enëve të përdorimit të përditshëm si enë tryeze të llojeve e varianteve të ndryshme. Fragmente vorbash që u perkasin shekujve IV-V (mbas Krishtit). Fragmente tasash tipesh të ndryshme, që mund të datohen në shek. II-III mbas Krishtit. Kurse motivi zbukurues në një fund tasi e vendos përdorimin e tij ndërmjet viteve 340-470 mbas Krishtit. Gjithashtu u gjetën edhe kryqe e copa të kryqeve, të skalitura në gurë apo materiale rrethanore.

***Kisha e shek. V-të në Hot:*** Prej kohësh në Hot të Malësisë Madhe (në një vend me toponimin e vjetër Kirza), nga banorët vendas “thirrej” edhe Gomila e Kishës, thuhej se ka pas ekzistuar një kishë shumë e vjetër e mbuluar nga gurët, dheu, shkurret, ferrat e drurë të ndryshëm pyjor. Nga eksplorimi i rrënojave të kësaj Kisha në Hot nën drejtimin e arkeologut të njohur Prof. Gëzim Hoxha u zbulua një “inventarë i bollshëm” i eksponateve apo copave arkitektonike si: kapitete dhe kollona guri të zbukurrara me gëdhëndje. Copëza (kolonash) prej guri, me gdhëndje me motive florale-bimore, shpendësh dhe kafshësh (të egra). Copa dhe copëza me zbukurim me gdhëndje me motive të ndryshme. Nga gëdhëndjet në gurë bie në sy kryqi, me një simetri perfekte e mjaftë imponante. Copëza të kapiteteve të dritareve, të kapiteteve për shtylla e pilastra si dhe copëza të pllakave ndarëse të nefëve. Copa të baptisterit apo kthine ku bëhej pagëzimi. Copza nga lteri, copëza me skalitje apo gëdhëndje të ndryshme në material tjegulle e tulle. Si dhe ndonjë copëz amfore qeramike. Gjithashtu shohim copëza nga “mozaiku” me gëdhëndje në gurët e dyshemes (shtrojes), ose veshjeve ansore, të brendësisë së kishës. Në “inventarin” e eksponateve të zbuluara të kishës ka copëza që ngjasojnë me ato të “ikonostaseve”. Duke vrojtuar me kujdes ndonjë copëz pllake na duket se ngjason sikur të ishte mbetje nga ndonjë pllakë sarkofagu. Nuk mund të mohohet se nga “inventari” i gjetur ka ndonjë copëz urne apo stole etjer. Për aq murë sa dallohet qartësisht, ai ngjason me murin ilir.

## **TRASHIGIMI DHE TOPONIME KISHASH NË MALËSI**

Në Grudë (Dinoshë), për shekuj, përveç ndertimeve urbane (qyteza etj) ka pasur të ndërtuar një ndër kishat më të hershme e më të njohura të trojeve të Malësisë Madhe e më gjërë, ***Kisha e Shën Mhillit***, themelet e të cilës i përkasin të pakten shekullit të pestë (kjo kishë e pa eksploruar deri tani). Një histori me vlera për

Kishën Kristiane ekziston në Treven e Kelmendit të Malesisë së Madhe ku jo rrallë studiues dhe historianë e identifikojnë emrin e kësaj treve me Shën Klementin, dhe me Kalanë ose Qytezen Klementiana. Një kishë e hershme kushtuar Shën Klementit, “mendohet” se ka ekzistuar që në vitin 1080 në vendin e quajtur Shpaja, Spaja (emri i vjetër i Vuklit) etj. Shën Klementi i parë ka qenë (Papë) zevendesi III i Shën Pjetrit në vitet 90-101, i cili u martirizua duke përhapur fjalën e Jezu Krishtit ndër paganë. Kelmendasit e konsideronin si shenjëtorin mbrojtës të tyre në tërë historinë e fisit bashkë me të edhe tempujt e lutjes ndër kisha. Kjo ishte arsyeja që kelmendasit i nderonin Papët e Romës. Këtë gjë e dëshmon në një relacion për kelmendasit dërguar Selisë së Shenjte në vitin 1636 nga At Bonaventura. Përsëri në krahinën e Hotit gjendet një gërmadh që ndodhet në anën perendimore të luginës së Spinjës, ku nga Qafkisha ose Qafa e Kishes lejon kalimin mbi kodrën që ndanë luginën e Spinjës me fushën e Tuzit. Rrënojat i kanë dhënë emrin e Qafës. Ato njihen nga rrëfimet si mbetje të një kisha. Megjithatë mbetjet e mureve, për aq sa duken sipër tokës nuk lënë ta dallosh karakterin e asaj ndërtese. Ajo formon një drejtkëndësh me gjatësi 14 hapa dhe gjërësi 5 hapa, anët e ngushta të të cilit janë në formën e një Apside Kisha”.

**Në Koplik**, është një tokë që quhet me emrin popullore Amull (afër liqenit të Shkodrës) ekziston **toponimi KISHET**, çfarë tregon se në këtë vend para qindra vitesh kishte të ndërtuara një Kishë apo më shumë, që i sherbenin qëndrës urbane të banuar të Koplikut të asaj kohe, i cili siç dihet shtrihej që nga Kalldruni e vijonte në drejtim të Shkodres. Këtu janë gjetur materiale të vjetra ndërtimi (tulla, tjegulla, gurë, llaç gelqereje, etj). Gjithashtu janë konstatuar themele kishash dhe varresh me simbole të qarta kristiane (kryesisht katolike), si dhe mbetje të ndërtimeve të tjera civile. Gjithashtu në varret e identifikuar, janë gjetur edhe rrasa gurësh në të cilat dalloheshin skalitje të kryqeve dhe figurave të ndryshme shenjëtore. Është interesant të theksojmë se toponimi Kishej (Chisagno) ka ekzistuar edhe si emër i një qëndre të banuar apo fshati i varur nga Arqipeshkëvia e Shkodrës, madje një studiues shkruan se Kisha e Shkodrës kishte shumë martirë, dhe i pari për të cilin flitet është Marku, famulltar i Kishajt, fshat që sot nuk ekziston. Ndoshta në këtë kompleks kishash duhen kërkuar kishat e njohura që u kushtoheshin Shen Marisë e Shen Lukës etj.

Po në Koplik mbi vendin e quajtur Godeja njihet edhe sot toponimi **Kisha e Qerkut** (disa i thonë kisha e Çardakut). Këtu deri vonë mbahen mend edhe themelet e një kisha katolike dhe shumë varre përreth saj. Këto varre kujtohen se kanë qenë të sistemuara me matriale dhe rrasa guresh dhe simbole kryqi. Gjurmët e fundit të këtyre vlerave historike (të pa eksploruara nga specialist të kësaj fushe), janë “zhdukur” në vitin 1968, kur kooperativa bujqesore me mjetet e kohës punoi, gërmoi e rrafshoi këto vlera. Një toponim tjetër që perdoret edhe sot është ai që quhet **Kisha e Ograjes**. Në këtë vend mbahen mend edhe themelet e një kisha të vjetër (shumshekullore), si dhe disa varre përreth. Varret e Kishes së Ograjes anash ishin të ndërtuara me mure guri, si edhe me matriale prej rrasash guri. Edhe këtu nuk mungojeshin simbolet kristiane, si kryqe e tj. Sipër qytetit të sotëm të Koplikut ekziston edhe toponimi **Kisha e Prozhmit**, mbi lagjen e sotme Llazan të Koplikut, ku ky vend dikur ka qenë pyllë apo prozhem.

**Në Fshatin Maçovilë** deri para 50-60 viteve kanë ezituar disa rrënoja që identifikoheshin nga banorë me një **Kishë** shumë të vjetër. Në Bajzë të Kastratit disa rrënoja shumë vjetra edhe sot identifikohen me emrin Kisha e Çartun. Në Zagorë (Shkrel) njihet toponimi, Kryqi i Kolajve, në fshatin Vuçë (Shkrel) ka pak rrenoja që dallohen ku edhe sot këtij vendi i “therrasin” Te Kisha. Në Vukël-Kelmend, trashigohet emri i vjetër i Kishës së Shën Klementit. “Gjurmë” të tilla toponimesh kristiane mund të “takohen” në Malin e Maranajit etj. Por gjurmë të “kishave” të lashta (shek.IV-VIII e më të vonshme) gjenden në Kalatë, qytezat apo qendrat urbane të hershme të Malësisë së Madhe e më gjërë, si ajo e Marshejit, Podgorës, Hotit, Medunit (kryeqyteti rezervë i Ilirisë) e deri te ajo më e vonë si Ballaza e Rrjollit, etj. Të gjitha këto të pa eksploruara nga arkeolog e specialist të kësaj fushe.

## LASHTËSIA E KRISHTERIMIT NDËR ILIRO-SHQIPTARË DËSHMOHET EDHE ME ANTROPONIMET E SHUMTA KRISTIANE

Lashtësinë e krishtërit ndër shqiptarë e dëshmojnë edhe antroponimet e shumta kristiane, të cilat janë përhapur bashkë me fenë e krishterë që në mijëvjeçarin e parë. Ndër emrat më të vjetër kristian, me përhapje në Veri e në Jug, janë: Gjon, Gjini, Gjergj, Shtjefen, Pjetër, Ndue (Anton), Lukë, Pal, Lekë, Mark, Rrok, Nikollë, Kolë, Llesh (Aleksandër), Mhill, Tomë, Mateo, Andrea, Nikë, Kostandin, Flor, Mri, Marie, Prenë, Luke, etj. Siç shihet emrat më të spikatur Kristian, me të cilët pagëzonin fëmijët, Iliro-Shqiptarët pas perqafimit të besimit Kristian ishin ata të apostujve e shenjtorëve Kristian. Vlenë të cilësohet se edhe ndër popujt e tjerë që përqaftuan besimin Kristian, duke përfshirë edhe fqinjët tanë të “vonë” sllav muarën mjaft emra kristian të shenjtorëve të këtij besimi apo kësaj feje monoteiste, pavarësisht nga “tingëllimi” i këtyre emrave në gjuhen e tyre.

## PAK INFORMACION PËR DISA KISHA PAS SHEKULLIT X-të

Emri i qytetit të lashtë *Balesium* del për herë të parë nga një letër që i drejtohet Arqipeshkevit të Tivarit në vitin 1062 nga Papa Aleksandër i II (Farlati, Iliricum sacrum). Ipeshkvia ishte në varësinë e arqipeshkevit të permendur. Me sa duket kishte qënë më parë nën metropolinë e Diokleas, e cila më vonë qe çvendosur në Tivar. Nën papa Klementin e IV (1342-1352) në Shqipëri filloi një veprimtari intensive e minoritëve dhe domenikanëve që vazhdon edhe nën Inoçentin VI dhe nën Urbanin V. Në krye të dioqezave erdhen shumë rregulltarë. Një vëmendje e madhe iu vu vijës shqiptare në veri, aty ku ajo përplasej me sllavët dhe që ishte e trazuar fort nga skizmatikët. Në vitin 1356 kisha e Balezit (Ballezës) dhe manastiri i Shen Gjonit në Strilaleo në Drishtë permenden si të shkatërruara nga skizmatikët. Ka gjasa siç thotë Hoffer se në vitin 1336 kisha e tij ipeshkvnore të këtë qënë e shkatërruar nga skizmatikët dhe në gjysmën e dytë të shekullit XIV qyteti të ketë qënë veçse një grumbull rrënojash. (Kujtojmë se kjo kohë i përket pushtimit sllav të Stefan Dushanit 1330-355). Rrënojat e tij në krahasim me të tjerat janë shumë të rralla, duke u katandisur në një murë rrethues dhe në gërmadhat e të ashtuquajturës Kisha e Balezit.

## MANASTIRI BENEDIKTIN I SHËN GJONIT

Rrënojat që gjinden sot në fshatin (Rash), Hysaj (Gruemirë-M.Madhe) i përkasin Kishës apo Manastirit të Shën Gjonit që ka një moshë rreth 900 vjeçare. Pikërisht për një moshë kaq të madhe “tregon” edhe studiuesi Ermanno Armao kur shkruan: *Kisha dhe kuvendi të shpien në kohë të largëta*. Një dokument i parë i vitit 1166 përmend abatin e kishës Sancti Johannis (Shen Gjonit në Rash të poshtëm). Abacia gëzonte sipas kohrave mbrojtjen e princërve dhe (më vonë) të Republikës Venedikasve”. Ndërsa albanologu kroat Milan Shufllaj shkruan se në këmbët e malit të Maranaj në fushën e Shtojit (Strilaleo) ishte abacia e Shen Gjonit.

## DISA TË DHËNA PËR KISHA NË SHKODËR

Një ndër kishat më të hershme në Shkodër, është *Kisha e Shën Shtjefnit* në Kalanë e Rozafes. Kjo kishë ka qënë ndërtuar në mes bazilikave të lashta të shekujve IV-VI, kishave të më pastajme romako-gotike, dhe manastireve benediktine është edhe katedralja e Shen Shtjefnit në Shkodër. Fatkeqësisht për hershmërinë e kësaj kishë nuk është “punuar”, si rezultat i disa konflikteve (verbale) klerikësh lokal. Historiani dhe albanologu i njohur Konstantin Jireček në një studim me titull: “Shkodra e Krahinat e saj në Mesjetë” tregon për disa kisha katolike të qytetit në shek. XIV ku ndër të tjera shenon: *kishen e Shën Mërisë, kishen Françeskane (1395), kishen e Shën Elisë në kuvend të Domenikaneve (1444)* e tjera. Ekzistencën e kishës së Shën Mërisë në Shkodër na e konfirmon edhe regjistri i kadastrës dhe koncensionëve të viteve 1416-1417, kur shënohen perkufizimet e shtëpisë (magazines N.B.) të një tregtari të Kripes, ku ndër të tjera shkruhet: Një shtëpi dërrasash e mbuluar me dërrasa dhe me kashtë, që gjendet perballë kështjellës, pranë

murit te qytetit i sipershënuari Gajard mban kripën e bashkisë, sipas kërkesës së zotërve të sipërthënë të llogarive të vjetra. Kufijet e saj janë nga njeri krahu, hendeku i barbakanit të kështjellës, nga krahu tjetër i saj Kisha e Shën Mërisë së Shkodrës , nga krahu tjetër muri i qytetit, e nga krahu tjetër i saj sheshi i kështjellës. Një kishë tjetër e njohur është **Kisha e vjetër e Shna Ndout** matanë Bunës, në “Kasenë”, ku janë rrënojat e Kishes së Shna Ndout. (Perveç kësaj ka qënë edhe **Kisha e Shën Kollit** e ortodokësve). Një dëshmi me vlera (viti 1478) për historinë e kishave është ajo e priftit dhe historianit shkodran Marin Barleti, i cili na “tregon” se në Shkodër ekzistonin Kishat që u kushtoheshin Shën Vlashit (Blasiusit), Shën Mërisë, Shën Lazrit, Shna Prenës (Shën Venerandës), Shna Kryqit, Shën Pjetrit, Shën Nikollës, Shën Shtjefnit (brenda kalasë), Shën Markut dhe Shën Marisë Magdalen. Në një relacion të Ispeshkëvit të Shkodrës dërgue me 27 maj 1780 kongreatës së propogandës Fide shkruhet: “Kisha e moçme e Shën Marisë Madalenë, gjendet kah ana tjetër e lumit Bunë, në malin e Kazenës të quajton Preva. Nga të gjitha këto objekte, kulti Kristian apo monumente besimi e qytetrimi, **Kisha e Zojës së Keshillit të Mirë** rrëzë kalasë Shkodrës kishte pasur një fat të dyfisht tragjik për Shkoderlocen, që për shekuj e kishte pasur pajtore të qytetit e më gjerë. Me 25 prill të vitit 1467, dy katolikë shkodran nga frika e përparimit të turqeve muarrën imazhin, portretin apo siç i thotë populli, figurën e “Zojës së Këshillit të Mirë” e njohur më shumë si “Zoja e Shkodrës” dhe e kaluan përtej Adriatikut në Xhenacano-Itali, rreth 27km në lindje të Romës. Aty Imazhi i saj u bë shumë i njohur në besimin popullor arbëresh. Edhe sot e kesaj dite, çdo 25 prill në orën nëntë të mëngjezit, të gjitha këmbanat e Xhenacanos bien në përkujtim të mërgimit dhe të pranisë së saj. Më vonë pëmendet edhe kisha e Shën Rrokut në Shirokë, etj.

## **KISHA TË “VONA” NË MALËSI TË MADHE**

Në trojet e Malësisë së Madhe në dy anët e kufirit politik (Shqipëri-Mali i Zi), kemi disa kisha, për të cilat ka “njoftime” të vona, gjatë shekujve XVII-XVIII-të, rrënojat e të cilave dallohen edhe sot, ose mbi ato rrënoja janë rindërtuar të reja: Nga këto kisha kemi evidentuar:

1. Kishën e Shën Gjon Pagzorit në Brigje-Hot, e vitit 1616
2. Kishën-Famulli të Traboinit-Hot, që i kushtohet të Lumes së Virgjër e v.1648
3. Kishën e Shën Nikollës-Selcë-Kelmend e v. 1651
4. Kishën e Shën Klementit-Vukël-Kelmend e v.1651
5. Kishën -famulli të Shën Markut, Prefekturë Apostolike, Katund të Kastratit, v.1669
6. Kisha e Shën Mhillit-Bogë, v.1669
7. Kisha -famulli e Zojës Rruzare e Trieshit, v.1672
8. Kisha e Shën Nikollës (Shënkollit-maj) e Bzhetës-Shkrel, v. 1745
9. Kisha e Shën Elisë-Reç, v.1745
10. Kisha e Shëlbuemit e Rrjollit.
11. Kisha e Shën Antonit (Shnandout) e Kojës, v. 1750

## **PERFUNDIME**

1. Për të gjitha këto kisha, të vjetra apo të “vona” kam pergatitur një monografi, me histori të zgjeruar e me referencat përkatëse për secilin objekt kulti Kristian, monografi të cilën mendoj ta botoj së shpejti.
2. Referati im modest shpresoj të vlejë sadopak për të shtuar vëmendjen ndaj kësaj trashigimie të besimit e qytetimit Kristian, rrënjët e të cilit i kemi të njëjta me Europën Përendimore, apo më “gjërë” me Bashkimin Europian.

## STUDIME MBËSHTEËSE DHE REFERENCA

1. Bibla, letrat derguar Romakëve 15;19.
2. Gaspër Gjini, Ipeshkëvia Shkup-Prizren nëpër shekuj, fq.60-61, Ferizaj 1992 + kalendari katolik i pëvitshtëm.
3. Edwin Jacques, Shqiptarët, fq.159, botim nga fondacioni Abraham Linkoln 1995.
4. Zef Mirdita; Gjashtë shekujt e parë të Kristianizimit në trevat Iliro-Shqiptare, Krishtërimi ndër shqiptarë, simpozium ndërkombëtar Tiranë, 16-19 nëntor 1999, fq.36, botua Shkodër 2000.
5. "ILIRIA BIBLIKE", Pergatitur nga Nikollë Loka e Gjet Kola, fq.25. GEER 2005.
6. Iliria Biblike pergatitur nga Nikollë Loka e Gjet Kola, po aty, fq.24.
7. Dr. Milan fon Shuflaj, Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke, fq.25, botime Franceskane, Shkoder 2013. Perkthyer dhe perg. per botim Dr. phil. MA Edmond Malaj. Botime Franceskane, Shkodër 2013.
8. Dr.Konstantin Jirecek [Shkodra e krahina e saj ne mesjet] Vezhgime Iliro-shqiptare,fq.109. sh.b."Camaj-Pipa" Shkodër 2004.
9. Gëzim Hoxha, Procesi i kristianizimit në Provimncën e Prevalit deri në fillimin e shek.VII, Krishtërimi ndër shqiptarë, simpozium ndërkombëtar Tiranë, 16-19 nëntor 1999, fq.76, botua Shkodër 2000.
10. Gëzim Hoxha, Procesi i kristianizimit në Provimncën e Prevalit deri në fillimin e shek.VII, Krishtërimi ndër shqiptarë, po aty fq.69.
11. Fulvio Kordinjano, SHQIPERIA permes vepres e shkrimeve te misionarit te madh italian At Domeniko Pazi ,VII.II, fq.49.Botime "Almera" 2007.
12. Dr. Milan fon Shuflaj, Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke , fq.28.
13. Konstantin Jirecek, po aty fq.111.
14. Hyacinthe Hecquard, Historia dhe pershkrimi i Shqipërisë së Eperme ose i Gegerisë, fq.51 + fq.420. Plejad 2008.
15. Hyacinthe Hecquard, po aty, fq.413.
16. Dr. Milan fon Shuflaj, Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke, fq.32, Perkthyer dhe perg. per botim Dr. phil. MA Edmond Malaj. botime Franceskane, Shkoder 2013.
17. Gëzim Hoxha, Procesi i kristianizimit në Provimncën e Prevalit deri në fillimin e shek.VII, Krishtërimi ndër shqiptarë, po aty fq.82.
18. Skender Anamali dhe Damian Komata; Varrezat e Kalldrunit, Kumtari i Muzeut popullor të Shkodres (3-4), fq.96, botim i vitit 1978.
19. Skender Anamali dhe Damian Komata, po aty fq.104.
20. Dr. Milan fon Shuflaj , Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke , po aty fq.122.
21. Kuvendi i Arbenit 1703, fq.35, botim i Shpresa Prishtine 2003.
22. Letër e dom Nikollë Gjorgës e 29 dhjetorit 1748, Italo Sarro, kontribut per historinë kishtare të Shqipërisë së Eperme shek.XVII-XIX, fq.12, botime Franceskane, Shkodër 2015.
23. Relacion i ipeshkvit Pal Kampsit mbi vjetin 1757, Italo Sarri, po aty fq.40-41.
24. Michel Lemonnier O.P, HISTORI E KISHES, zhvillimi i jetës së kishës nga Rrëshajat deri ne ditët tona, fq.66, përkthye shqip nga Ferdinand Leka, enti botues "Gjergj Fishta".
25. Dr. Milan fon Shuflaj, Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke ,po aty fq.31...
26. Zamir Tafilica , Muzeu Historik i Shkodrës, Kumtari-6- fq.43-51, Shkodër 1993.
27. Kisha u eksplorua nën drejtimin e arkeologut të njohur, Prof. Gëzim Hoxhës, si dhe në kuadër të projektit: "Rritja e bashkëpunimit, antikitetet e krishtera në funksion të zgjerimit të turizmit",



financuar nga Bashkimi Evropian, si pjesë e Programit të Bashkëpunimit ndërkufitar IPA Shqipëri – Mal i Zi. E zbatuar nga Dioqeza e Budimjes dhe Nikshiqit, në bashkëpunim me ACA – Albania Community Assist (Asistencë për Komunitetin në Shqipëri), Muzeun Polimlje – Berane, dhe Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Arkeologjisë-Tiranë, si dhe në bashkëpunim me Bashkinë Malësi e Madhe. Konferenca e promovimit u organizua në Hot te vendi i rrënojave të zbuluara të bazilikës , kishës paleokristiane dhe e drejtuar nga Znj.Holta Koçi, drejtore e Asistencës për Komunitetin në Shqipëri. është promovuar në Hot me 27 shtator 2019.<sup>2</sup>

28. Dom Nikë Ukgjini, Vështrim i shkurtër historik për fisin e Kelmendit, fq.84.
29. Theodor Ippen ,SHQIPERIA E VJETËR, Studime gjeografike, etnografike e historike .fq.259. Shtypshkronja Maluka, Tiranë 2002.
30. Hyacinthe Hecquard, po aty, fq. 421.
31. Gojdhëna të mbledhura nga unë Ndue Bacaj, të cilat qarkullojnë edhe sot nga banorët vendali të Koplikut.
32. Kolec Topalli, Lashtësia e krishterimit ndër shqiptarë sipas dëshmimeve të gjuhës shqipe, Krishtërimi ndër shqiptarë, simpoziumi ndërkombëtar 16-19 nëntor 1999 fq.405-407. Botimi Shkodër 2000.
33. Dr.Milan fon Shuflaj ,Situata e kishës në Shqipërinë paraturke, fq.60, perkthyer dhe perg. per botim Dr. phil. MA Edmond Malaj, botime Franceskane, Shkoder 2013.
34. Fulvio Kordinjano, SHQIPERIA, permes vepres dhe shkrimeve te misionarit madh italian At Domeniko Pazi, 1847-1914, fq.33, vll.2.
35. Ermanno Armao; Vende, Kisha, Lumej, Male e toponime të ndryshme të një harte të lashtë të Shqipërisë Veriore, fq.140. Botime Korbi, Tiranë 2006.
36. Dr.Milan Shuflaj; Serbet dhe Shqiptaret fq.211, Tiranë 2002.
37. Ermanno Armao, Vende, Kisha, Lumej, Male e Toponime të ndryshme të një Harte të lashtë të Shqipërisë Veriore, Fq.130-131.
38. Vezhgime Iliro-Shqiptare (Kostandin Jirecek) ,fq.117.
39. Regjistri i kadastres dhe koncensioneve të Shkodrës 1416-1417, Perg.nga Akademia e shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historise, fq.23.Tiranë 1977.
40. Hamdi Bushati, Shkodra dhe Motet, pjesa e parë , fq.611 , Shkodër 1998.
41. Marin Barleti, Rrethimi i Shkodres, fq.86, 88, 101, 108, 120, 141. Botoi dhe shtypi-Votra, Shkup 2009.
42. Italo Sarro, Kontribut për historinë kishtare të Shqipërisë së Eperme shek.XVII-XIX ,fq.121-122 , botime Franceskane, Shkodër, 2015.
43. Edwin Jacques, SHQIPTARET, po aty, fq. 220-221.